

Alfred
Kanini

Shirat e vjeshtës

tregime
dhe
novela

BIBLIOTI
SHITIT

814-32

K 29

-32
29

S

ALFRED KANINI

Shirat e Vjeshtës

LIBRARI E BASHKËSI
SHIRAT E VJESHËS

Shirat



1421

Tregime dhe novela

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LUGINA

Mbi luginë presin një grumbull njerëzish. Ata kanë kohë që presin. Mbase që në mëngjes. Megjithatë, asnjëri nuk guxon t'i thotë Muhinit të lexojë telegramin. Ai e ka lexuar mirë, se di dhe të shkruajë, dhe të këndojë. Mirëpo poshtë në luginë i biri me nusen s'po duken akoma. As krushqit s'po bëjnë të parë. Muhini e di se krushq mund të mos vijnë, po mendon se mbase ata të nuses ruajnë ndonjë zakon dhe i përcjellin. Prandaj herë pas here vështron luginën. Ai nuk e vret mendjen pse e kanë quajtur «Lugina e nuseve». Bile mendon se kanë bërë mirë që e kanë quajtur ashtu. Se nëpër të kanë kaluar të gjitha nuset e fshatit. Dhe nusja e të birit andej do të kalojë. Ai nuk di se kur kishin filluar ta quanin atë «Lugina e nuseve». Edhe nusja e të atit, edhe ajo e gjyshit, edhe të tjerat nëpër atë luginë kishin ardhur në fshatin e tyre. Edhe nuset e tij. Ai ka kohë që mendon për nuset e tij. Prandaj nuk ju zemërua të birit kur ky i shkroi se kishte gjetur një nuse, një nuse me dashuri si i thonë. Fundja pse t'i zemërohej. . . I biri kishte mbaruar shkollën e lartë dhe e kishin mbajtur në qytet. I kishte ardhur keq që ja kishin mbajtur të birin. Ai mendonte se atë

punë mund ta bënte dhe ndonjë tjetër. Mirëpo ata thoshin se i biri ishte i zoti. Të birit i qe lutur që dasmën ta bënin në fshat. Fundja të gëzonin edhe ata.

«Veç jo sipas zakoneve», i kishte thënë i biri.

Muhini vështron edhe një herë luginën. Mbi të ka rënë dielli, një diell që i fshik shkëmbinjtë e ngrënë nga shirat duke u dhënë një bukuri të ashpër. Dasmorët nuk po duken. Fshatarët i hedhin Muhinit vështrime pyetëse. Ata kanë marrë edhe armë me vete. Madje dhe disa kuaj për të rendur më parë në fshat e t'u japin lajmin se po vinte i biri i Muhinit me krushq e me dasmorë...

Muhini vështron luginën dhe aty si dy pika të vogla lëvizin dy njerëz. Ata dredhojnë midis shkëmbinjve, zbresin e zbresin në luginë, aq ngadalë. sikur të kenë dalë shëtitje. Kur afrohen dhe ca, Muhini dallon se janë dy burra ngaqë të dy janë veshur me pantallona dhe duken njësoj të gjatë e me lëvizje të sigurta. Fshatarët vazhdojnë ta pyesin në heshtje, po ai nuk guxon të japë urdhër të shkrehin armët. Mbase nuk janë ata. Muhini pret të afrohen dhe ca, pret në heshtje me sytë të të dy njerëzit që kalojnë nëpër «Luginën e nuseve. . .»

*

*

*

Të dy ecin njëri pas tjetrit në një shteg shkëmbor. Dielli ka filluar të djegë dhe fytyrat u janë skuqur e mbushur me bulëza djerse.

— Jona, u lodhe? — pyet ai.

Jona nuk thotë se u lodh. Asaj i janë mpirë të gjitha gjymtyrët dhe mezi lëviz dhe megjithatë nuk mundohet aspak ta fshehë lodhjen.

— Po ku është ajo «Lugina e nuseve»? — pyet ajo e lodhur.

— Ti po ecën pikërisht në luginë.

Ai e vështron një çast në sytë e gjelbër. Ajo duket sikur nuk mendon asgjë. Megjithatë ai e di se Jona bluan diçka.

— Edhe unë kalova nëpër këtë luginë — thotë ajo duke psherëtirë dhe duke vështruar me frikë shkëmbinjtë e mëdhenj e të zes që duken sikur do të shemben nga çasti në çast. — E kishe menduar se dhe nusja jote do të kalonte nëpër këtë luginë?

— Po, e kisha menduar. Ndryshe nusja ime nuk ka nga të kalojë — thotë ai duke vënë buzën në gaz. — Njëherë mësuesi ynë e quajti «Luginë të lotëve.» Fshatarët e morën vesh nga fëmijët e tyre. Edhe unë i thashë tim eti. Mirëpo ai tundi kokën dhe tha se nuk e kishte keq mësuesi. Do të ishte mirë të quhej «Lugina e lotëve».

— E pse t'u përgjegj ashtu? — pyeti Jona.

— Këtë e kuptova vonë, — thotë ai — vonë e kam kuptuar. Dhe ai kishte të drejtë.

Mbi luginë dëgjohen të shtëna armësh. Mesa dukej, Muhini kishte njohur të birin.

— Jona, unë nuk të kam treguar diçka që ka të bëjë edhe me këtë luginë.

Ajo e vështron e shqetësuar dhe mendja fillon t'i punojë me shpejtësi. Lodhjen nuk e ndjen më.

— Mos ke kaluar me ndonjë nuse në djep nëpër këtë luginë? — e pyet ajo.

Ai e kupton gjendjen e saj. Vë buzën në gaz padashur dhe i përgjegjet i nxituar:

— Jo, im atë... Ka të bëjë me tim atë...

Ata filluan të linin luginën dhe diellin që kishite nisur të përvëlonte. . .

*

* * *

Në dhomën ku e shpunë ishin vetëm gra e vajza. Asaj i janë afruar dy gra të thyera pak në moshë dhe e vështrojnë me kujdes. Pastaj e përqafojnë me radhë. Në fillim njëra dhe pastaj tjetra. E para ruan ende shenjat e një femre të bukur, ndërsa e dyta tiparet e një malësoreje të ashpër. Në sytë e së parës vihej re dhembshuri, ndërsa të së tjetrës durim. Jona nuk e di se kush janë ato dy gra. Megjithëse i pëlqejnë që të dyja, fillon të druhet nga ato, sepse nuk e di se kush janë. Sa keq që nuk ndodhet Asimi. Tani që duhej të ndodhej, e shpunë në dhomën tjetër. Nga sa mori me mend ajo, në dhomën tjetër janë burrat. Aty e kish të ndaluar të hynte, ashtu siç e kishte të ndaluar Asimi të vinte tek ajo. Megjithatë ajo vendosi të njihej vetë me ato dy gra që kishin bërë pak mënjanë dhe nganjëherë diç u thoshin ca të rejave.

— Kush jeni ju? — pyet Jona atë të dytën, meqë e kishte më afër. E dyta habitet nga një pyetje e tillë. E vështron si me qërtim dhe hedh sytë nëpër dhomë për të hetuar se mos e kishin dëgjuar edhe të tjerat atë që bëri nusja.

— Është nëna! — thotë Asimi dhe u afrohet atyre të dyjave. Në dhomë fillojnë pëshpëritje. Asimi i di zakonet, megjithatë ka hyrë në dhomën e grave. Disa gra dhe vajza dalin fshehurazi. Asimi vë buzën në gaz. Jona habitet kur dalin ato dhe u hedh vështrimin e saj hetues vajzave dhe grave që kanë mbetur. Dhe përsëri habitet.

Te ndonjëra vë re buzëqeshje, te të tjerat habi. Asaj i vjen t'ja mbathë. T'i lerë të gjitha dhe t'ja mbathë. Asimi duhej t'ja kishte shpjeguar të gjitha këto. I kujtohet ajo lugina, ajo lugina e ashpër, nëpër të cilën duhet të kalojë çdo vajzë që hyn nuse në fshat, nën ata shkëmbinjtë e thepisur që të ngjallin frikë. Kur ecte nëpër të, vetja i dukej e vogël, e pafuqishme. I dukej sikur, po të ndiqte ndonjë shteg tjetër, shkëmbinjtë e ashpër do të çaheshin dhe do të rrokulliseshin mbi të.

Pastaj hedh vështrimin te të dy gratë.

— Po kjo kush është? — pyet Asimin duke treguar të parën. Ai hesht ca. E para pret me durim përgjegjen e Asimit. Ai mundohet të mos e vonojë.

— Nëna — thotë. — Edhe kjo është nëna.

«Si nëna? pyet vështrimi i habitur i Jonës.

— Nëna — thotë prapë Asimi duke mos u mundur t'i mbushë mendjen Jonës se kudo nëna është vetëm një. Megjithatë Jona e kupton të shoqin. Ajo gjithnjë e ka kuptuar. Mbase kjo ishte ajo që kishte të bënte me plakun Muhin, që ai ja kishte fshehur. Dhe mendimi për t'ja mbathur nëpër «Luginën e nuseve.» i tulatet dhe largohet dalëngadalë diku në dhomën tjetër ku qëndrojnë burrat.

— Më njih me të gjithë farefisnin tënd — i thotë ajo.

Ai i vështron dy nënat. Njëra nga ato është e shqetësuar, ndërsa tjetra e vështron me habi...

*
* *
*

— Cila nga ato është nëna e vërtetë? — e pyet ajo.

— Ajo e para.

— Ajo e bukura?

— Jo, tjetra — thotë ai.

— Si është puna që janë bërë dy? — pyet ajo.

— Ato shkojnë mirë, bile shumë mirë — thotë ai i hutuar.

— Edhe mua më vjen çudi si është kjo punë.

— S'ma ha mendja të shkojnë dhe aq mirë — thotë ajo. — Fytyra e asaj që s'e ke nënë më duket e trishtuar.

— Ajo është e mirë — thotë ai. — Unë e kam dashur njësoj si nënën time. Im atë është munduar të mos e fyejë kurrë.

— Po si ka ndodhur? — pyet ajo.

— Ajo duhej të ishte nusja e zhaxhait tim — nis të tregojë ai. Ai ka qenë i fejuar me të. Im atë kishte dhjetë vjet që ishte martuar. I vëllai ka qenë më i ri, i rrëmbyer dhe kokëshkretë. Kishte kërkuar vajzën më të bukur të fshatit më të afërt prej këndeje. Fshati mban një tri orë. E fejuara e bukur i rrezikoi kokën. E lajmëruan se një gjini e madhe dhe me shumë djem ja kishte vënë synë nuses së tij dhe e këshilluan të hiqte dorë nga ajo. Mirëpo tim ungj nuk e hante shumë merakun se ç'thoshin të tjerët. Natën e dasmës e vranë. Nusja mbeti në kullën tonë. Im atë kishte hyrë në gjak me një gjini të madhe dhe të fortë. Atëhere ata hapën fjalë se do të rrëmbenin nusen. Po të dilte nusja nga dera e burrit, ajo shtëpi mbetej e turpëruar. Asnjëri nuk pyeste për nusen. Ajo ishte si një baulle që kishte zënë vendin e saj në shtëpinë tonë. Im atë nuk dinte si të bënte. Kishte mbetur i vetmi burrë në familje. Po të lëshonte nusen e të vëllait, do t'i mbetej dera e turpëruar për jetë, po ta mbante, duhej të lante gjakun e të vëllait dhe kështu do t'i

shkretohej shtëpia. Plot një vit ndenji nusja e xhaxhait edhe e lidhur, edhe e zgjidhur në kullën tonë, gjersa vëllezërit e saj i erdhën tim eti në shtëpi.

— Duhet ta marrësh — i thanë.

— Unë e kam një — u tha im atë.

— Le ta kesh — i thanë prerë. — Nusja jote nuk po bën fëmijë. Ka dhjetë vjet që nuk po bën.

— Mbase do të bëjë — nguli këmbë im atë.

U zvarris dhe ca kohë puna. Hasmët deklaruan se do ta rrëmbenin nusen dhe do ta vrisnin tim atë. Erdhën vëllezërit e nënës sime dhe i thanë se duhet të merrte nusen e vëllait.

«Unë e kam një», ngulte këmbë im atë.

I tha dhe im më një ditë. Zakoni nuk e lejonte, po megjithate ajo i tha:

— Duhet ta marrësh. Mbase unë nuk lind fëmijë.

— Ti mbylle — i tha ai.

— Ty të duhet një djalë.

— Të thashë ta mbyllësh! — i tha prapë ai.»

Mirëpo e kërcënuan gjini e fis dhe do të kishin hyrë në hasmëri, po të mos kishte vendosur më në fund të merrte nusen e vëllait. U bë dasmë e madhe, mbase më e madhe se me tim më...

— Po ajo? — pyet Jona.

— Kush?

— Nëna jote.

Asimi vë një cigare në gojë dhe e ndez me çakmakun e bardhë. Pastaj nxjerr një psherëtimë. Jona vendos të mos e pyesë më. Atyre u është afruar një vajzë tetë vjeçe. E pastër, e veshur me rroba të krahinës. Vajza është një zeshkane me sy të kaltër, çuditërisht të kaltër. Jona i vë asaj të dy duart mbi

flokë dhe e përqafon. Pastaj e pyet duke i afruar gojën te veshi:

— Si të quajnë?

— Nuriye — thotë vajza.

— Po mbiemrin?

Vajza e sheh e habitur dhe ngre supet.

— Nuk e di.

Jona vë buzën në gaz.

— Është motra — thotë Asimi. — Prej babe.

Jona e kupton që ajo është e asaj tjetrës, se i ngjan shumë. I hedh përsëri duart në flokët e zes dhe e përkëdhel. Pastaj drejton trupin dhe vështron Asimin.

— Po ti, si ke menduar? — e pyet ajo.

— Në fillim i kam dashur të dyja njësoj — thotë ai. — Po mendoj se kjo është diçka jo e rregullt.

Ajo e vështron përsëri vajzën e vogël. Pastaj e merr për dore dhe i shkon krahun Asimit. Ndjen se ai rrëqethet. Mendon se ai ka filluar ta ndjejë veten nën pushtetin e zakoneve. Befas ajo ngre sytë dhe e vështron.

— Po si ndodhi që linde ti? — e pyet.

Ai nguron të përgjegjet, pastaj i thotë me gjysmë zëri:

— Atë vit nëna ime mbeti me barrë...

*
* *
*

Ata kanë qëndruar pranë derës së dhomës së burrave dhe nuk kanë vendosur akoma të hyjnë. Që andej vijnë zëra.